



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2020

Lënda: Dërgohet formulari i njoftimit të fituesit (Kopje e përmbledhur e cila do të publikohet në buletin)

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë**

Autoriteti Kontraktor: Adresa, nr. tel: Bashkia Shkodër L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", tel+35522400150.

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur (prokurim publik me mjete elektronike).

Objekti i prokurimit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): “ **Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i ish Konviktit te shkolles veterinare)**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-70709-09-03-2020**

Fondi limit **79,302,921** (Shtatedhjete e nentemilion e treqind e dymije e nenteqind e njezet e nje) leke pa tvsh

Burimi i Financimit: Ky fond është vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Viti 2020 për investime sipas VKB nr.34 date 07.08.2020'Per miratimin e perdorimit te fondit rezerve per zbatimin e projektit:"Rikonstruksion i godinave ne pronesi te njesive te Vetqeverisjes vendore per strehim social"Rikonstruksion i ish Konviktit te shkolles veterinare" dhe Buxheti i Shtetit sipas shkreses nr.13712/1 prot date 17.07.2020 nga Ministria e Financave dhe"Njoftim mbi fituesit e projekteve te strehimit per vitin 2020"detajuar si me poshte:

Financimi nga Buxheti i Shtetit me vlere prej **63,449,998**(Gjashtedhjete e tremilion e katerqind e dyzet e nentemije e nenteqind e nentedhjete e tete) leke pa tvsh dhe **76,139,997.6**(Shtatedhjete e gjashtemilion e njeqind e tridhjetete e nentemije e nenteqind e nentedhjete e shtate pike gjashte) leke me tvsh i detajuar nder vite si me poshte:

1. Financimi per vitin 2020 eshte **20,097,936.67** (Njezetmilion e nentedhjete e shtatemije e nenteqind e tridhjetete e gjashte pike gjashtedhjete e shtate)leke pa tvsh dhe **24,117,524**

(Njezet e katermilion e njeqind e shtatembedhjetemije e peseqind e njezet e kater)leke me tvsh

2. Financimi per vitin 2021 eshte **20,833,333.33** (Njezetmilion e teteqind e tridhjete e tremije e treqind e tridhjete e tre pike tridhjete e tre)leke pa tvsh **25,000,000** (Njezet e pesemilion)leke me tvsh
3. Financimi per vitin 2022 eshte **22,518,728** (Njezet e dymilion e peseqind e tetembedhjetemije e shtateqind e njezet e tete)leke pa tvsh **27,022,473.6** (Njezet e shtatemilion e njezet e dymije e katerqind e shtatedhjete e tre pike gjashte)leke me tvsh

Financimi nga Buxheti i Bashkise

1. Financimi per vitin 2020 eshte **15,852,923**(Pesembedhjetemilion e teteqind e pesedhjete e dymije e nenteqind e njezet e tre)leke pa tvsh dhe **19,023,507.6**(Nentembedhjetemilion e njezet e tremije e peseqind e shtate pike gjashte)leke me tvsh

Vlera e shpallur fituese (nqs ka lotë e ndarë sipas loteve):**75,073,897,5** (Shtatedhjete e pesemilion e shtatedhjete e tremije e teteqind e nentedhjete e shtate pike pese) leke pa tvsh.

Data e zhvillimit të tenderit: data **05.10.2020, ora 10.00**.vendi:Njesia e Prokurimeve Publike Bashkia Shkodër.

Operatori/et ekonomik i/të shpallur fitues:“**OUEN**”sh.p.k NUIS K17529215O & “**SHPRESA - AL**”sh.p.k NUIS K31321021N perfaqesuar me prokure te posacme nga “**OUEN**” sh.p.k Adresa: Kukes Malzi SHEMRI Lagjja Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Zona Kadastrale Nr.3335, Nr.Pasurie 593/1.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

VOLTANA ADEMI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 21 / 10 / 2020

Nga: Bashkia Shkodër. Adresa: L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", Tel & Fax +35522400150.

Për: "OUEN" sh.p.k NUIS K175292150 & "SHPRESA - AL" sh.p.k NUIS K31321021N
perfaqesuar me prokure te posacme nga "OUEN" sh.p.k Adresa: Kukes Malzi SHEMRI Lagjja
Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Zona Kadastrale Nr.3335, Nr.Pasurie 593/1.

-Procedura e prokurimit: **Procedure e Hapur.**

-Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-70709-09-03-2020**

-Përshkrim i shkurtër i kontratës: " **Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i ish Konviktit te shkolles veterinare)**".

Fondi limit **79,302,921** (Shtatedhjetë e nentemilion e treqind e dymije e nenteqind e njezet e nje) leke pa tvsh

Burimi i Financimit: Ky fond është vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Viti 2020 për investime sipas VKB nr.34 date 07.08.2020 Per miratimin e perdorimit te fondit rezerve per zbatimin e projektit: "Rikonstruksion i godinave ne pronesi te njesive te Vetqeverisjes vendore per strehim social" Rikonstruksion i ish Konviktit te shkolles veterinare" dhe Buxheti i Shtetit sipas shkreses nr.13712/1 prot date 17.07.2020 nga Ministria e Financave dhe "Njoftim mbi fituesit e projekteve te strehimit per vitin 2020" detajuar si me poshte:

Financimi nga Buxheti i Shtetit me vlere prej **63,449,998** (Gjashtedhjetë e tremilion e katerqind e dyzet e nentemije e nenteqind e nentedhjetë e tete) leke pa tvsh dhe **76,139,997.6** (Shtatedhjetë e gjashtemilion e njeqind e tridhjetë e nentemije e nenteqind e nentedhjetë e shtate pike gjashte) leke me tvsh i detajuar nder vite si me poshte:

1. Financimi per vitin 2020 eshte **20,097,936.67** (Njezetmilion e nentedhjetë e shtatemije e nenteqind e tridhjetë e gjashte pike gjashtedhjetë e shtate) leke pa tvsh dhe **24,117,524** (Njezet e katermilion e njeqind e shtatembedhjetemije e peseqind e njezet e kater) leke me tvsh
2. Financimi per vitin 2021 eshte **20,833,333.33** (Njezetmilion e teteqind e tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre) leke pa tvsh **25,000,000** (Njezet e pesemilion) leke me tvsh

3. Financimi per vitin 2022 eshte **22,518,728** (Njezet e dymilion e peseqind e tetembedhjetemije e shtateqind e njezet e tete)leke pa tvsh **27,022,473.6** (Njezet e shtatemilion e njezet e dymije e katerqind e shtatedhjete e tre pike gjashte)leke me tvsh

Financimi nga Buxheti i Bashkise

1. Financimi per vitin 2020 eshte **15,852,923**(Pesembedhjetemilion e teteqind e pesedhjete e dymije e nenteqind e njezet e tre)leke pa tvsh dhe **19,023,507.6**(Nentembedhjetemilion e njezet e tremije e peseqind e shtate pike gjashte)leke me tvsh

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

-Afati i përfundimit të punimeve: **12(Dymbdhjete) muaj.**

-Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike datë **08.09.2020 nr.66.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **05.10.2020, ora 10.00.**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori ekonomik“**KEVIN KONSTRUKSION**“ shpk me administrator z. Lavdrim Gjici. NUIS K 71401004 W
Vlera e ofertes se paraqitur prej **57,054,450** leke pa tvsh(Pesedhjete e shtatemilion e pesedhjete e katermije e katerqind e pesedhjete).
- 2- Bashkimi i operatoreve ekonomik “**Ndregjoni**”sh.p.k NUIS K31329048I &"**Udha**" shpk NUIS K 77524909 Q përfaqesuar me prokurë të posacme nga operatori ekonomik “**Ndregjoni**” shpk me administrator z. Xhetan Ndregjoni.
Vlera e ofertes se paraqitur prej **59,065,220** leke pa tvsh(Pesedhjete e nentemilion e gjashtedhjete e pesemije e dyqind e njezet).
- 3- Bashkimi i operatoreve ekonomik “**EURO-ALB**”sh.p.k NUIS K66613407H &"**VIANTE Konstruksion**"sh.p.k NUIS K47103804L përfaqesuar me prokurë të posacme nga operatori ekonomik “**EURO-ALB**” shpk me administrator z.Bujar Murati.
Vlera e ofertes se paraqitur prej **66,615,408.8** leke pa tvsh(Gjashtedhjete e gjashtemilion e gjashteqind e pesembedhjete mije e katerqind e tete presje tete).
- 4- Bashkimi i operatoreve ekonomik”**OUEN**”sh.p.k NUIS K17529215O & “**SHPRESA - AL**”sh.p.k NUIS K31321021N perfaqesuar me prokure te posacme nga “**OUEN**” sh.p.k me administrator z.Mehmet Hilaj.
Vlera e ofertes se paraqitur prej **75,073,897,5** (Shtatedhjete e pesemilion e shtatedhjete e tremije e teteqind e nentehjete e shtate pike pese) leke pa tvsh.
- 5- Operatori ekonomik“**Lala**“ shpk me administratore z. Jonuz Lala. NUIS J76418903B.
Vlera e ofertes se paraqitur prej **77,479,762.5** leke pa tvsh(Shtatedhjete e shtatemilion e katerqind e shtatedhjete e nentemije e shtateqind e gjashtedhjete e dymije pike pese) .
- 6- Operatori ekonomik “**ELDA VL**” sh.p.k nuk ka paraqitur oferte.

Ka ofertues te skualifikuar.

1. U skualifikua operatori ekonomik “ KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k per keto arsye:

- a) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton – 2 cope. Shoqeria Geci shpk disponon certifikata per transport per llogari te vete per keto dy mjete. Pra nuk eshte i autorizuar te bej transport per llogari te te treteve. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 – 1 cope. Mjetit me targa TR0482T i ka perfunduar siguracioni me date 03.10.2020. Pra eshte i pavlefshem per kete procedure prokurimi. Autovinc – 1 cope. Shoqeria Denolt shpk disponon certifikate per transport per llogari te vete. Pra nuk eshte i autorizuar te bej transport per llogari te te treteve. Kontrata e qeraseshte pa objektin e prokurimit sipas percaktimeve ne piken 19,te kapacitetit teknik te DST.
- b) Autorimorkiator mjetesh – 1 cope. Shoqeria Denolt shpk disponon certifikate per transport per llogari te vete. Pra nuk eshte i autorizuar te bej transport per llogari te te treteve. Kontrata e qeraseshte pa objektin e prokurimit sipas percaktimeve ne piken 19,te kapacitetit teknik te DST.
- c) Autobote uji – 1 cope. Kontrata e qeraseshte lidhur me qiradhenesin personin fizik Z. Kreshnik Duraku per mjetin me targa AA297LY eshte e pavlefshme per kete procedure prokurimi, pasi i mungon certifikata e transportit, ne kundërshtim me kerkesat per kualifikim te percaktuara nga autoriteti kontraktor. Kontrata e qeraseshte pa objektin e prokurimit sipas percaktimeve ne piken 19,te kapacitetit teknik te DST.
- d) Nuk keni paraqitur dokumentacion per kamioncinen me targa TR3196R te cilen e keni te deklaruar tek shtojca e makinerive.
- e) Kontrata e qeraseshte per 2(dy) autobetoniere eshte pa objektin e prokurimit sipas percaktimeve ne piken 19,te kapacitetit teknik te DST.

2. U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik “Ndregjoni”sh.p.k & "Udha" sh.p.k. per keto arsye:

- a) Bashkimi i operatoreve ekonomike “Ndregjoni” sh.p.k. & “Udha” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 1.a, kjo pasi Formulari i Ofertës Ekonomike nuk është plotësuar siç duhet, pasi nuk është drejtuar autoritetit kontraktor Bashkia Shkoder por është drejtuar Ujësjiellës kanalizime Tiranë sh.a. në cilësinë e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, ka mospërputhje të vlerës së ofertës të shprehur me numra me atë të shprehur me fjalë.
- b) Bashkimi i operatoreve ekonomike “Ndregjoni” sh.p.k. & “Udha” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 2.3 Per kapacitetin teknik: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvojë të suksesshme në ekzekutimin e të paktën:
 - a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo me te vogel se 39,651,461 (Tridhjetë e nentemilion e gjashtëqind e pesedhjetë e njemije e katerqind e gjashtedhjetë e nje) leke të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit

ose

b. Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit , të jete në një vlerë jo me te vogel se 158,605,842 (Njeqind e pesedhjetë e tetemilion e gjashtëqind e pesemije e teteqind e dyzet e dy) lekë.

Lidhur me këtë pikë ofertuesi të paraqese :

-Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

-Kontratësipermarrjet.

- Situacionin përfundimtar.

-Akt-kolaudimin.

-Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, ofertuesi do ta vërtetojë këtë pune duke paraqitur Formularin e vlerësimit sipas shtojcësNr. 9, shoqëruar me:

-Kontratë sipërmarrje.

-Situacionin përfundimtar.

-Akt kolaudimi objekti.

-Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit.

Shoqëria “Ndregjoni” sh.p.k. ka paraqitur për këtë procedure prokurimi, kontratën me objekt “Rikonstruksion i shkollave të njësisë administrative Shupenzë, Bashkia Bulqize”, ku referuar aktit të kolaudimit dhe çertifikatës së marrjes në dorëzim të objektit rezulton se punimet për këtë objekt kanë përfunduar me datë 09.09.2017. Procedura e prokurimit, është zhvilluar me datë 05.10.2020. Pra, ky objekt është realizuar jashte afatit 3 vjeçare. Për kontratën me objekt “Godine industriale dhe ekonomike 1 dhe 2 kat, në pronësi të Z. Hetem Barjami”, nuk është firmosur akti i kolaudimit nga mbikqyrësi i punimeve Ing. Leonora Pacili. Prandaj, kjo kontratë nuk do të merret në shqyrtim gjatë fazës së vlerësimit, pasi paraqet të meta thelbësore.

Ka paraqitur kontratën me objekt “Rikonstruksion i shkollës së Mesme - Shtiçen, Bashkia Kukës” me vlerë 17,453,178 Lekë pa tvsh. Për këtë kontrat është paraqitur akti i marrjes në dorëzim, i cili nuk është firmosur nga grupi i marrjes në dorëzim të objektit. Prandaj, kjo kontratë nuk do të merret në shqyrtim gjatë fazës së vlerësimit për shkak të të metave që paraqet.

Ka paraqitur kontratën me objekt “Mirembajtje e thellë e palestrave në objektet arsimore” me vlerë 28,891,408 Lekë pa tvsh.

Ka paraqitur kontratën me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Mamëz, Bashkia Kukës” me vlerë 20,423,647 Lekë pa tvsh.

Kontrata me objekt “Rikonstruksion i Shkollës 31 – Korriku”, e realizuar nga shoqëria “UDHA” sh.p.k. 90% (Ish Vllaznia Ndertim I.S) dhe shoqëria “Ndregjoni” sh.p.k. 10% paraqet mangësi në dokumentacion, konkretisht, situacioni përfundimtar nuk është firmosur nga inxhinieri rezident i mbikqyrësit të punimeve Ing. Zenullah Mehmeti. Proces Verballi i marrjes në dorëzim të punimeve nuk është i firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesit e përfituesit të investimit Shkolla 31 – Korriku. Për më tepër faturat tatimore të shitjes janë prerë 100% nga

shoqëria “UDHA” sh.p.k. (Ish Vllaznia Ndertim I.S), në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

c) Bashkimi i operatoreve ekonomike “Ndregjoni” sh.p.k. & “Udha” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 2.3.3 Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimi” (Deklarate nga administratori i shoqërisë) Asnje nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh ekonomik nuk ka paraqitur vetëdeklarim që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

d) Bashkimi i operatoreve ekonomike “Ndregjoni” sh.p.k. & “Udha” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për 6(gjashte) muajt e fundit duhet të jetë jo më pak se 50 (Pesdhjete). Këta punonjës nuk duhet të jenë të angazhuar në kontratë/kontrata të tjera si kontraktor apo nënkontraktor për të njëjtën periudhë të zbatimit të kontratës që po prokurohet me Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder. (Deklaraten nga administratori i shoqërisë) Asnje nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh ekonomik nuk ka paraqitur vetëdeklarim që këta punonjës nuk duhet të jenë të angazhuar në kontratë/kontrata të tjera si kontraktor apo nënkontraktor për të njëjtën periudhë të zbatimit të kontratës që po prokurohet me Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder.

e) Shoqëria “Ndregjoni” sh.p.k. nuk ka plotësuar sakte deklaratën mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas shtojcës 11, pasi nuk ka deklaruar kontratat me Bashkinë Kamez

f) Te gjitha kontratat e qerases së makinerive të paraqitura nga shoqëria “Ndregjoni” sh.p.k. me shoqëritë Lezha Beton sh.p.k., Kast&Gaz sh.p.k., dhe H.S person fizik janë pa objektin e prokurimit sipas përcaktimeve në pikën 19, të kapacitetit teknik të DST

g) Certifikates së transportit të automjetit me targa MT3419A i ka mbaruar afati i vlefshmerisë me datë 12.06.2020

h) Certifikates së transportit të automjetit me targa AA711ND i ka mbaruar afati i vlefshmerisë me datë 19.05.2020

j) Leje profesionale e mjekut të shoqërisë Udha sh.p.k. nuk është e plotë pasi nuk mund të verifikohet viti I lëshimit.

3. U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik “EURO-ALB”sh.p.k &“VIANTE Konstruksion”sh.p.k per keto arsye:

a) Bashkimi i operatoreve ekonomike “EURO-ALB” sh.p.k.&“VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 2.2.4 ”Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron apo ka ushtruar aktivitet për vitin 2019 (Sipas QKB) sipas percaktimeve ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore per vitin 2019” Referuar vertetimit të oshee-se Nr. 744 Prot. Datë 25.09.2020, të paraqitur për këtë procedure prokurimi, të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Burrel, rezulton se operatori ekonomik ”Euro-Alb” sh.p.k. ushtron aktivitet në adresat Burrel, Shijak dhe Tirane, për të cilat ka kontrata të lidhura me operatorin e shpërndarjes së energjise elektrike. Për vitin 2018 ky operator ekonomik ka paraqitur vërtetim nga këto 3 bashki për pagimin e taksave dhe tarifave vendore. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Shijak për vitin 2019.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomike “EURO-ALB” sh.p.k. & “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 2.3 Per kapacitetin teknik:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvojë të suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo me te vogel se 39,651,461 (Tridhjetë e nentemilion e gjashtëqind e pesedhjetë e njemije e katerqind e gjashtedhjetë e nje) leke të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit

ose

b) Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit , të jete në një vlerë jo me te vogel se 158,605,842 (Njeqind e pesedhjetë e tetemilion e gjashtëqind e pesemije e teteqind e dyzet e dy) lekë.

Lidhur me këtë pikë ofertuesi të paraqese :

-Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

-Kontratë sipermarrjet.

- Situacionin përfundimtar.

-Akt-kolaudimin.

-Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, ofertuesi do ta vërtetojë këtë pune duke paraqitur Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me

-Kontratë sipërmarrje.

- Situacionin përfundimtar.

-Akt kolaudimi objekti.

-Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit.

Ky bashkim operatorësh ekonomik nuk ka arritur të plotësoj asnjërin nga kriteret sa më sipër. Kontratat e paraqitura nga këto dy shoqëri janë si më poshtë: Shoqëria “EURO-ALB” sh.p.k. ka paraqitur 3 kontrata të vlefshme me dokumentacion të plotë sipas kërkesave të përcaktuara në DST, me vlerë totale prej 24,223,000 Lekë pa t.v.sh. Gjithashtu, ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën me objekt “Rindertim i shkolles 9 – vjecare “Muharrem Dollaku” Shijak”, e cila është lidhur ndërmjet sipërmarrësve bashkimit të operatoreve ekonomike “Euro-Alb” sh.p.k. dhe “Viante Konstruksion” sh.p.k., kurse Formulari i Vlerësimit shtojca 9 është lëshuar sikur punimet për realizimin e këtij objekti janë realizuar 100% nga shoqëria “Euro – Alb” sh.p.k. Referuar aktit të kolaudimit të objektit është pasqyruar fakti që punimet janë realizuar nga bashkimi i operatoreve ekonomike “Euro-Alb” sh.p.k. dhe “Viante Konstruksion” sh.p.k. Të gjitha veprimet sa më sipër bien ndesh me përcaktimet e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Neni 74 “Bashkimi i Operatorëve Ekonomik”, pika 5 ku është parashikuar:

“5. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatoreve ekonomike ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.”

Pra, ligji ka parashikuar qartë rastet se kur mundet që një nga anëtarët e bashkimit të operatoreve ekonomik pasi kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes të mund të largohet apo zëvendësohet me anëtarët e tjerë të bashkimit.

Për gjithë sa më sipër, kjo kontratë nuk mund të merret në shqyrtim për këtë procedurë prokurimi, pasi vetë ofertuesi për faj të tij nuk ka arritur të paraqes dokumentacion të plotë dhe të saktë ku të vërtetohet pjesën takuese të realizuar nga secili prej anëtarëve të bashkimit.

b) Shoqëria “Viante Konstruksion” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht nuk plotëson pikën 2.3.7 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jete prezent gjatë gjithë kohës në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.

Shoqëria “Viante Konstruksion” sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratë për drejtuesin teknik të punimeve në objekt, megjithatë ka pjesë në këtë procedurë prokurimi sipas përcaktimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit. Për sa më sipër, kjo shoqëri ka dështuar në plotësimin e kësaj pike.

c) Bashkimi i operatoreve ekonomike “EURO-ALB” sh.p.k. & “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, nuk plotëson pikën 2.1.a, pasi rezulton se ky operator ekonomik ka nderhyre në preventivin e tenderuar, në kundërshtim me Seksionin 1 të Dokumentave Standarde të Tenderit “Hartimi i ofertës”: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

Në preventivin e tenderuar nga Autoriteti Kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomike “EURO-ALB” sh.p.k. & “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k. në ofertën ekonomike ka hequr nga preventivi disa nga sasitë e përcaktuara në preventivin e publikuar në web www.app.gov.al nga AK për këtë procedurë prokurimi, konkretisht ka hequr sasitë për zërat si më poshtë:

Kreu I “Punime dheu”, zërat 1, 2.

Kreu V “Punime H/Izolimi dhe çatie”, zërat 7, 10.

Kreu VI “Punime shtresash”, zërat 4, 6.

Kreu VII “Punime tavani e suvatimi”, zërat 1, 2, 3.

Kreu VIII “Punime suvatimi e veshje me pllaka” zëri 2.

Kreu X “Punime Bojatisje”, zërat 1, 2.

Kreu XI “Punime të ndryshme dhe prishje”, zëri 4.

Ashtu sic parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në sasi apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Ndryshimi i sasive në preventiv apo heqja dhe mos ofertimi për të gjithë zërat e preventivit, ndryshon kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit dhe për këtë arsye nuk mund të lejohet korrigjimi i ofertës pasi nuk jemi në rastin e gabimit aritmetik dhe të mospërputhjes së cmimeve gjatë përlogartjes së ofertës ekonomike, sic parashikohet në rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, oferta ekonomike e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomike “EURO-ALB” sh.p.k. & “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k. s'kualifikohet nga procedura e prokurimit.

d) Shoqëria ”EURO-ALB” sh.p.k. nuk ka plotësuar sakte deklaratën mbi kontratat e lidhura apo ne process sipas shtojcës 11, pasi nuk ka deklaruar kontratën me Bashkinë Kamez publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.82 date 05.10.2020

c) Licenca e mjekës H.K që shoqëria ”EURO-ALB” sh.p.k. ka pjesë të stafit të saj është jashtë afatit të vlefshmerisë pasi ajo duhet të rinovohej përpara tre muajve.

d) Te gjitha kontratat e qerases së makinerive të paraqitura nga shoqëria ”EURO-ALB” sh.p.k. me shoqëritë D&A sh.p.k., Loti sh.p.k., dhe me personat fizikë E.O dhe H.V janë pa objektin e prokurimit sipas përcaktimeve në pikën 19, të kapacitetit teknik të DST.

e) Te gjitha kontratat e qerases së makinerive të paraqitura nga shoqëria ” VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k. me shoqëritë Ares Construction sh.p.k., Vagalat sh.p.k., Isabar sh.p.k. janë pa objektin e prokurimit sipas përcaktimeve në pikën 19, të kapacitetit teknik të DST.

f)Nuk keni paraqitur kontraten e punes dhe diplloren per inxhinierin mekanik,drejtues teknik ne licence XH.N.Ne SPE keni paraqitur dy here te njejtin dokumentacion per inxhinierin mekanik S.J

4. U skualifikua operatori ekonomik “**ELDA VL**” shpk per keto arsye:

a)Ju nuk keni paraqitur asnje dokument

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Bashkimi i operatoreve ekonomik”**OUEN**”sh.p.kNUISK175292150&“**SHPRESA - AL**”sh.p.k NUISK31321021N perfaqesuar me prokure te posacme nga “**OUEN**” sh.p.k me administrator z.Mehmet Hilaj.Adresa: Kukes Malzi SHEMA Lagjja Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Zona Kadastrale Nr.3335, Nr.Pasurie 593/1,se oferta e paraqitur me nje vlere te pergjithshme prej **75,073,897,5** (Shtatedhjete e pesemilion e shtatedhjete e tremije e teteqind e nentedhjete e shtate pike pese) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesise se Prokurimeve Publike,Bashkia Shkodër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.Gjithashtu duhet te paraqitni te gjithe dokumentacionin e hedhur ne tender origjinal ose kopje te noterizuar, te numerizuar dhe te inventarizuar.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) /, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 13.10.2020.

Ankesa.Nuk ka patur

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
VOLTANA ADEMI**

